



07/09/2022

Lezhë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Garden”

Vijojnë kontrollet për goditjen e rasteve të mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit, në banesë apo në ambiente të tjera.

Finalizohet operacioni policor i koduar “Garden”.

Kishte fshehur armën e zjarrit në ambientet e jashtme të banesës së tij, vihet në pranga 57-vjeçari.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Lezhë, në vijim të kontrolleve në ambiente të ndryshme, me qëllim parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative se një shtetas mbante armë zjarri pa leje, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Garden”.

Gjatë këtij operacioni, është ushtruar kontroll në ambientet e banesës së shtetasit Rr. K., 57 vjeç, banues në Zejmen. Si rezultat, në ambientet e jashtme të banesës së këtij shtetasi, është gjetur e fshehur një armë zjarri automatik, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Në vijim të veprimeve, u arrestua në flagrancë shtetasi Rr. K., 57 vjeç, banues në Zejmen, për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

#angazhimpërkushtimsakrificë 🚔 🚓

#tëvendosurkundërkrimit ✅

#nëçdoskajtëvendit 🇲🇰

#nëshërbimtëqytetarëve 🚔 🤝 👮

Share

Share

Share

Share

Email

Kërko

Enter a word for search 🔍

Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

- Linqe
- > Arkiva
 - > Akademia e Sigurisë
 - > Ministria e Brendshme
 - > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
 - > Interpol
 - > Europol
 - > Misioni PAMECA V
 - > SCPA
 - > Projekti Trivalent